



Dita e Esperantos:

Për botën, për gjithë gjuhët dhe pa diskriminim gjuhësor.

Neni 2 i deklaratës për të drejtat e njeriut pohon qartë se “të gjitha të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Deklaratë vlejnë njësoj për të gjithë njerëzit, pa asnjë lloj diferencimi, qoftë për racën, ngjyrën e lëkurës, seksin, gjuhën, fenë, mendimin politik apo tjetër, prejardhjen kombëtare apo shoqërore, pronësinë, lindjen apo gjendje tjetër.”

Në vetvete, kjo e dënon mohimin e të drejtave gjuhësore të njeriut, të grupeve, etnive, bashkësive të vogla, të dobëta, pa ndikim politik dhe pohon pozitivisht nevojën për të luftuar kundër diskriminimit gjuhësor.

Çfarë është diskriminimi gjuhësor?

Kjo ndodh sa herë njerëz më të fortë, më të fuqishëm, më të arsimuar, më të pasur flasin në gjuhët e veta amtare me njerëzit e gjuhëve të tjera, gjë kjo po kaq e vjetër sikurse skllavëria, vlerësimi i ulët për gratë, vrasja pa u dënuar e të dobëtëve, shfrytëzimi ekonomik i vendeve të dobëta, racizmi dhe praktika të ngjashme të padrejta. Por, ka një ndryshim në krahasim me diskriminimet e tjera: diskriminimi gjuhësor nuk njihet shpesh nga ata, që e bëjnë diskriminimin dhe madje nga ata që diskriminohen. Kombet e Bashkuara vetë, që janë pika e vetme e dialogut, që e ka planeti ynë, nuk e zbatojnë plotësisht këtë, që deklarata për të drejtat e njeriut e ka përfshirë:

çdo barazi ta kuptojmë dhe të kuptohet.

OKB ka disa gjuhë të mëdha si gjuhë zyrtare, por, në fakt, përdor vetëm disa nga më të mëdhatë për t'i folur botës. Si rrjedhojë, ajo priret të dëgjojë vetëm atë pjesë të vogël të botës, që është e aftë të përgjigjet në këto gjuhë të mëdha. A është kjo mënyra më ndikuese për t'i mobilizuar qytetarët e botës për të gjetur zgjidhje për problemet e rëndësishme botërisht, për shembull Synimet për Zhvillim të Qendrushëm, dialogu për klimën apo kërkimi i paqes?

Disa politikanë udhëheqës afrikanë e kanë pranuar krejt qartë lidhjen midis përdorimit të gjuhëve amtare dhe zhvillimit, sikurse Julius Nyerere dhe Nelson Mandela, që ka thënë dikur:

“ Në se ju i flisni njeriut në gjuhën që ai e kupton, ju i flisni kokës së tij, por në se i flisni atij në gjuhën e tij, ju i flisni zemrës.”

Dhe ne kemi nevojë të mobilizojmë zemrat rreth synimeve të Kombeve të Bashkuara!

Zgjidhja që propozojnë folësit e gjuhës asnjëse botërore Esperanto është mbase më tepër për të ardhmen për t’u zbatuar në shkallë të madhe, por ia vlen të interesohemi për të, sepse ajo është një gjuhë e krijuar që në botë secili të ketë të drejtë ta flasë gjuhën e vet pa trysni nga gjuhët e mëdha. Esperanto ka qenë krijuar që të gjitha gjuhët të jetojnë, dhe që dialogu ndërmjet grupeve të ndryshme të bëhet pa trysinë e njërës gjuhë ndaj tjetrës , por në mënyrë të barabartë, pa përdallime.

Nu bëjmë thirrje, me rastin e Ditës së Esperantos të këtij viti, me 26 korrik, që ju ta mësoni Esperanton jo thjesht për të mësuar një gjuhë më shumë, edhe pse ajo është krahasimisht e lehtë, por për të kuptuar se çfarë është diskriminimi gjuhësor, që e praktikon atë dhe qysh mund ta kapërcejmë këtë me një komunikim të barabartë.